



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 02 dhjetor 2019, në mbledhjen e XVIII-të (tetëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Valmire Lahu, Mefail Rama, ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Ahmet Ahmeti, koordinator i njësitit për të drejtat e njeriut në Komunën e Podujevës, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare e Kosovës, Tomi Lengej, përfaqësues i KFOR – LMT, Bekim Karaxhija përfaqësues nga OSBE-së

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të ditës.

Fillimisht u mbajt 1 minutë heshtje për viktimat e tragjedisë nga tërmeti në Shqipëri.

Kryesuesja ndër të tjera vazhdoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

1. Informatë e koordinatorit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Komunën e Podujevës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, para se ta merr fjalën koordinatori për të drejtat e njeriut në Komunën e Podujevës, deshta të shtoi se të gjithë njerëzit jemi të barabartë dhe kemi të gjitha të drejtat e barabarta si në strehim, punësim, shkollim dhe gjitha fushat tjera të cilat natyrisht se mbrohen me legjislacion përkatës që i referohet lirisë dhe barazisë, mirëpo sa do që janë ato të

drejta tonat si komunitet RAE, sa mbrohem i dhe sa trajtohem i të barabartë në institucione, e dim shumë mirë se kemi diskriminime dhe nuk trajtohem i çdo herë të barabartë.

Sa i përket Komunes së Podujevës, ne si komunitet RAE trajtohem i të barabartë qoftë në shkollim, punësim, strehim dhe sektorë tjera të ndryshme, andaj për informata tjera fjalën ja kaloj zyrtarit të cekur.

z.Ahmet Ahmeti, koordinator për të drejtat e njeriut në Komunën e Podujevës, fillimisht shprehi falënderime për ftesën duke shtuar që ndihem i nderuar që jam më i afërt me Komitetin tuaj i cili bënë një punë të mirë dhe është funksional në gjitha fushat.

Sa për sqarim me organogramin e Komunes së Podujevës, në kuadër të Ekzekutivit të Komunes respektivisht si pjesë përbërëse e Zyrës së Kryetarit të Komunes është Njësia për të drejtat e njeriut e cila si Njësi udhëhiqet nga unë dhe në kuadër të të cilës është zyrtari për barazi gjinore dhe zyrtari për të drejtat e fëmijëve. Njësia ka përgjegjësi të monitoroj nga afër realizimin e të drejtave të njeriut në tërësi duke përfshirë edhe në institucionet komunale në kuadër të Komunes së Podujevës. Aktivitetet e punës së përhershme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal – Departamenti për të drejtat e njeriut, pastaj kohë pas kohe kemi raporte edhe me Avokatin e Popullit si dhe me institucione tjera lokale me të cilat pothuajse me të gjitha kemi një bashkëpunim shumë të mirë, siç janë, Policia e Kosovës, pastaj zyrtarët që punojnë në njësitin-zyrën kundër dhunës në familje, etj, pra kryesisht merremi me këto aktivitete të përhershme. Kryetari i Komunes, kohë pas kohe, duke qenë në dijeni për peshën dhe rëndësinë që ka Njësi, gjithëherë në komitete dhe komisione të ndryshme që ndërlidhen me këtë fushë, cakton edhe një nga zyrtarët e këtij Njësi siç është komitete komunal vepruar, i cili është themeluar për zbatimin e planit dhe Strategjisë komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë 2017 – 2021.

Meqë tani jemi në muajin dhjetor, aktivitetet e fundit tonat janë të ndërlidhura kryesisht nga muaji tetor dhe që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të njeriut përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta dhe në këtë aspekt në kuadër të aktivitetit, me Shoqatën Handikos-Podujevë, kemi paraparë dhe realizuar një ditë pune, me kompensim-mëditje simbolike me nga 10 €, për 10 persona me nevoja të veçanta, me qëllim që edhe ata persona të përfshihen dhe të ambientohen sa do pak me punën në administratën komunale, përndryshe besoj që jeni në dijeni se jemi të obliguar edhe me ligj që një numër i personave të kësaj kategorie të jenë të punësuar në kuadër të administratës komunale dhe shërbimeve tjera, gjë të cilën e kemi respektuar dhe kemi të punësuar persona të kategorisë në fjalë, natyrisht me kualifikime përkatëse dhe në bazë të procedurave përkatëse ligjore.

Mandej në kuadër të një aktiviteti i cili lidhet me këtë muaj që jemi, përkatësisht nga 25 nëntori i cili vazhdon për 16 ditë dhe ka të bëjë me aktivitete të ndryshme kundër dhunës në familje, e në kuadër të kësaj edhe ne si Komunë kemi planifikuar dhe kemi përgatitur një sërë aktivitetesh lidhur me këtë çështje deri në përmbyllje që do të jetë 10 dhjetori, datë në të cilën është paraparë një marsh së bashku me nxënës dhe personel të shkollës së mesme ekonomike, pasi të kryhet një debat publik në atë shkollë (me nxënës të klasëve të XII-ta), marsh i cili do të jetë përgjatë qendrës së qytetit deri tek sheshi “Ali Ajeti” ku edhe do të përmbyllet, ditë e cila ndërlidhet edhe me Kartën Universale për të Drejtat e Njeriut. Aktiviteti është paraparë të mbahet bashkërisht me Policinë e Kosovës, Qendrën për Punë Sociale, Shoqërinë Civile etj.

Pra kjo ishte në pika të shkurtra rreth punës dhe aktiviteteve të Njësitit për të drejtat e njeriut, ndërsa për çështje tjera që jeni të interesuar mund t’ju jap përgjigje dhe sqarime të nevojshme.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin për informata e dhëna. Meqë kjo ishte vetëm një informatë, unë personalisht nuk kam diçka tjetër, mirëpo nëse ka të interesuar për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo vazhdojmë me punë.

2. Ngjitja e Grupit Punues për vlerësimin e raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2019, dhe hartimi i Planit të Punës për vitin 2020.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, nëse flasim për raportin e punës me siguri se të gjithë jemi në dijeni rreth punës që kemi bërë, mbledhjeve të mbajtura dhe aktivitetet tjera që kemi pasë duke theksuar vizitat në fshatra, shkolla dhe lagje të ndryshme ku jetojnë familje të Komitetit jo shumicë, pavarësisht që disa vizita të planifikuara nuk kemi mundur t'i realizojmë, mund të themi se ka qenë një vit i mbarë dhe i suksesshëm sa i përket fushëverpimtarisë së Komitetit.

Po ashtu në kudër të kësaj pike kemi paraparë edhe ngritjen e një Grupi punues për hartimin e Planit të punës për vitin 2020.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, theksoi, sa për sqarim, rreth kësaj teme mund të themi se është e nevojshme ngritja e një grupi për vlerësimin e raportit të punës së Komitetit gjatë vitit 2019. Gjithashtu është e nevojshme edhe ngritja e grupit punues për hartimin e planit të punës për vitin 2020.

Pra, tema duket paksa konfuze por konsideroj se është shumë e qartë dhe është e juaja që të ngritni një grup vlerësues për punën e Komitetit për vitin 2019 dhe në takimin e radhët të kemi një informatë, dhe në kuadër të kësaj mundeni që i njëjti grup të hartoj propozim planin e punës së Komitetit për vitin 2020.

Informata është mirë të jetë me shkrim dhe të paraqiten punët, aktivitetet dhe vizitat e bëra gjatë vitit që po lëm pas.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, konsideroj se nuk paraqet ndonjë problem sa i përket ngritjes së grupit punues dhe përgatitjes së informatës për punët dhe aktivitetet në vitin 2019 dhe planit të punës për vitin 2020. Kemi draftet nga viti i kaluar dhe vetëm do t'i përshtatim dhe inkorporojmë çështjet tjera që mund të dalin.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, vitin e kaluar kanë qenë 5 anëtarë në këtë Grup punues, andaj mund të vazhdojmë me punë. Propozimi im është në kuadër të grupit të fjalë të jenë; Unë, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani ose Valbona Podvorica dhe Mefail Rama.

z.Bashkim Sylja, theksoi, pajtohem si do që të ngritet ky grup punues, por do të kërkoja që sot të caktohen data dhe vendi i takimeve për arsye që të të jemi paraprakisht të informuar sepse ndonjëra prej nesh mund të jetë i zënë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, nëse jeni të pajtimit do të propozoja që takimi të mbahet më 12.12.2019 nga ora 11:00 këtu në këtë sallë ku jemi.

Pas konsultimeve, njëzëri nga anëtarët u ngrit Grupi punues për vlerësimin përkatësisht përgatitjen e informatës rreth punëve dhe aktiviteteve të komitetit për vitin 2019 si dhe hartimin e planit të punës për vitin 2020, me këtë përbërje:

- 1.Albina Avdiu,
- 2.Benjamin Ejupi,
- 3.Bashkim Sylja,
- 4.Valbona Kadriu - Podvorica
- 5.Mefail Rama

Po ashtu njëzëri u pajtuan që takimi të mbahet më 12 dhjetor 2019 nga ora 11:00 në sallën e mbledhjeve nr.31.

3. Të ndryshme

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, meqë jemi në fund vit dhe kemi festat e fund vitit do të ishte mirë që të mundësohej shpërndarja e dhuratave për fëmijët me nevoja të veçanta dhe atyre me gjendje të rëndë sociale ekonomike.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, një kërkesë e tillë me shkrim, nga ky Komitet do të mund t'i bëhej fillimisht Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ose Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Si ide është mjaft e mirë dhe do të ishte mirë të ndihmoheshin fëmijët e kategorive të përmendura, mirëpo a mund të jetë e realizueshme sepse tani jemi në fund vit dhe janë disa procedura rreth shpenzimit të buxhetit, mandej kemi edhe një numër të familjeve të ardhura dhe strehuara nga Shqipëria, pas tërmetit të ndodhur atje e që janë duke u marrë me ato familje sa kam informata, mirëpo është mirë të iniciohet kjo kërkesë qoftë edhe në Drejtorinë e Arsimit ndoshta mund të ndërmerret ndonjë veprim.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, atëherë po i marrim këto sugjerime dhe të shohim pastaj se si do të procedojmë me kërkesën në fjalë. Nëse nuk ka ndokush diçka për të shtuar, e mbyllim këtë mbledhje të fundit për këtë vit, duke iu uruar festat e fund vitit dhe vitin e ri 2020.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0090982/19

Podujevë,

02 dhjetor 2019

Kryesuese e Komitetit

Albina Avdiu
